



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44, 45 & 84, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01nr.110-391 dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik, 01nr.110-288305 dt. 31.12.2014, dhe në bazë të kërkesës 05nr.350/02 - 236767/22 dt.28.10.2022, e kërkuarit: Subjektit juridik, "Hill OIL"sh.p.k. nga Peja, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139, dhe me pronar Hekuran Pasha nga Peja, rr."Jashar Pasha"nr.16 në Pejë, për **ndryshim – plotësim** të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, të caktuara nga kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë afariste me Karakter të përkohshëm dhe me destinim: Pikë e shitjes së karburanteve, restaurant, barnatore & market, me P+0, në kuadër të PZHU-së, konkretisht parcelave, nr.332-6, 332-12, 333-4 & 333-5 ZK Çagllavicë, në pronësi të pronarëve/qiradhënësve: Kemal Kameri, Nebi Jusufi dhe Arlind Azemi nga Prishtina, bazuar në aktet noteriale "Kontratë për qira", me LRP.nr.3803/2021 dhe Ref.nr.653/20201 dt.30.07.2021; LRP.nr. 3954/2021 dhe Ref.nr.687/20201 dt.05.08.2021, të përpiluara te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë, Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë për vendosjen e çështjes administrative sipas kërkesës, me datë 10.11.2022, merr këtë:

V E N D I M

**NDRYSHIM- PLOTËSIM I VENDIMIT TË KUSHTEVE NDËRTIMORE 05NR.350/02 – 184195/21
DT.29.10.2021**

I. **Miratohet** kërkesa 05nr.350/03 - 236767/22 dt.28.10.2022, e kërkuarit / subjektit juridik, "Hill OIL"sh.p.k. nga Peja, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139, dhe me pronar Hekuran Pasha nga Peja, rr."Jashar Pasha"nr.16 në Pejë, për **ndryshim – plotësim** të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, të caktuara nga kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë afariste me Karakter të përkohshëm dhe me destinim: Pikë e shitjes së karburanteve, restaurant, barnatore & market, me P+0, në kuadër të PZHU-së, konkretisht parcelave kadastrale nr. 332-6, 332-12, 333-4 & 333-5 ZK Çagllavicë (pas ndarjes parcela kadastrale nr.1952-1 ZK Çagllavicë), në pronësi të pronarëve / qiradhënësve: Kemal Kameri, Nebi Jusufi dhe Arlind Azemi nga Prishtina, bazuar në aktet noteriale "Kontratë për qira" me LRP.nr.3803/2021 dhe Ref.nr.653/20201 dt.30.07.2021; LRP.nr.3954/2021 dhe Ref.nr.687/20201 dt.05.08.2021, të përpiluara te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë.

II. **Ndryshim - plotësim** i vendimit të kushteve ndërtimore nga paragrafin I. i këtij vendimi ka të bëjë me ndryshimet, si më poshtë:

• Në paragrafin III. pika 1, nga teksti:

- nr.332-6; S=389m²; Arlind Azemi; "Arë e klasit 4";
- nr.332-12; S=500m²; Nebi Jusufi; "Arë e klasit 4";
- nr.333-4; S=500m²; Kemajl Kameri; "Arë e klasit 4";
- nr.333-5; S=500 m²; Kemajl Kameri; "Arë e klasit 4";

Totali: S=1,889m².

Bëhet teksti:

- nr.1952-1; S=1,565m²; Arlind Azemi, Kemajl Kameri, Nebi Jusufi; "Arë e klasit 4";

• **Në paragrafin IV. pika 3, nga teksti:**

- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë / gabarit të përdheses, lejohet max.40%, duke mos përfshi pjesën e parcelës me destinim aktual në hapësirë publike:

$$S=1,889 \times 0.4(40\%)=755.60m^2 / \text{sipas rregullores/}$$

$$S=755m^2 / \text{sipas projekt propozimit/}$$

Bëhet teksti:

- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë / gabarit të përdheses, lejohet max.40%, duke mos përfshi pjesën e parcelës me destinim aktual në hapësirë publike:

$$S=1,565 \times 0.4(40\%)=626m^2 / \text{sipas rregullores /}$$

$$S=626m^2 / \text{sipas projekt propozimit të korigjuar /}$$

• **Në paragrafin IV. pika 4, nga teksti:**

- Dimensionet e ndërtesës të planifikuara, sipas projekt propozimit janë: Marketi me zyrë, barnatore dhe nyje sanitare, ka formë trapezi me dimensione: 29.50m'(jugu) x 33m'(veri) x 11m'(perëndim) x 14.5m'(lindje) dhe me sipërfaqe totale $S=372.84m^2$; Pika e shitjes – strehës në formë katërkëndëshi me dimensione: 29.40m' (jugu & veri) x 18.50m' (lindja - perëndim) me sipërfaqe totale $S=373.68m^2$ si dhe me hapësira ajrore në pjesën e veriore me $S=170.80m^2$;

Bëhet teksti:

- Dimensionet e ndërtesave të planifikuara, sipas projekt propozimit, janë: Marketi me zyrë, barnatore dhe nyje sanitare, ka formë trapezi me dimensione: 29.50m'(jugu) x 33m'(veri) x 11m'(perëndim) x 14.5m'(lindje) dhe me sipërfaqe totale $S=372.84m^2$; Pika e shitjes – strehës, në formë katërkëndëshi me dimensione: 29.40m' /jugu & veri / x (8.95m' & 8.40m') /lindja – perëndim/, me sipërfaqe totale $S=253.72m^2$;

• **Në paragrafin IV. pika 11, nga teksti:**

$$S=1889 \times 0.4(40\%)=755.60m^2 / \text{sipas vendimit/}$$

$$S=756m^2 / \text{sipas projekt propozimit/}$$

Bëhet teksti:

$$S=1,565 \times 0.4(40\%)=626m^2 / \text{sipas vendimit /},$$

$$S=628m^2 / \text{sipas projekt propozimit /},$$

• **Në Paragrafin XII. nga teksti:**

- Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore të kategoria "Arë e klasit 4", në tokë ndërtimore, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr. 02/L-26, dt. 24.06.2005 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 41/2006, dt. 27.12.2006, që rregullojnë këtë fushë, duhet të realizohet pas fuqizimit të kushteve ndërtimore dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në departamentin përkatës të sajë.

Pasi për Planin Zhvillimor Komunal nuk është marrë pëlqim nga MBPZHR, për shndërrimin e tokave bujqësore në tokë ndërtimore, dhe parcelat kadastrale nr. 332-6, 332-12, 333-4 & 333-5 ZK Çagllavicë përfshihet në PZHU, andaj procedura e ndërrimit realizohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me aplikim dhe me pëlqimin paraprak nga kjo drejtori.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjdhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=1,889m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore;

Bëhet teksti:

- Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore të kategoria "Arë e klasit 4", në tokë ndërtimore, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr. 02/L-26, dt. 24.06.2005 dhe Udhëzimit Administrativ të MBPZHR nr. 41/2006, dt.27.12.2006, që rregullojnë këtë fushë, duhet të realizohet pas fuqizimit të kushteve ndërtimore dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit

– “zgjdhja urbane”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=1,565m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore;

III. **Ky vendimi** është pjesë përbërëse e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02–184195/21 dt.29.10.2021, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Kërkuesi: Subjekti juridik “Hill OIL”sh.p.k. nga Peja, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139 dhe pronar Hekuran Pasha nga Peja, rr.”Jashar Pasha”nr.16 në Pejë, me kërkesën 05nr.350/02-236767/22 dt.28.10.2022, ka kërkuar nga kjo drejtori **ndryshim – plotësim** të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, të caktuara nga kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë afariste me Karakter të përkohshëm dhe me destinim: Pikë e shitjes së karburanteve, restorant, barnatore & market, me P+0, në kuadër të PZHU-së, konkretisht parcelave, nr.332-6, 332-12, 333-4 & 333-5 ZK Çagllavicë, në pronësi të pronarëve/ qiradhënësve: Kemal Kameri, Nebi Jusufi dhe Arlind Azemi nga Prishtina, bazuar në aktet noteriale “Kontratë për qira” me LRP.nr.3803/2021 dhe Ref.nr.653/20201 dt.30.07.2021; LRP.nr.3954/2021 dhe Ref.nr.687/20201 dt.05.08.2021, të përpiluara te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë.

Bashkangjitur me kërkesë për plotësim-ndryshim të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-236767/22 dt.28.10.2022, dhe gjatë fazës së trajtimit të kërkesës, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshmia mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 1952-1 & 1952-2 ZK Çagllavicë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, të lëshuara nga kjo drejtori.*

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës 05nr.350/02-236767/22 dt.28.10.2022 për **ndryshim–plotësim** të kushteve ndërtimore të subjekti juridik “Hill OIL”sh.p.k. nga Peja, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139, dhe me pronar Hekuran Pasha nga Peja, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, konstatoi se:

Kërkuesi: Subjekti juridik “Hill OIL”sh.p.k. nga Peja, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139 dhe me pronar Hekuran Pasha nga Peja, rr.”Jashar Pasha”nr.16, pas arritjes së marrëdhënieve kontraktuale me pronarët e parcelave kadastrale nr. 332-6, 332-12, 333-4 & 333-5 ZK Çagllavicë, Kemal Kameri, Nebi Jusufi dhe Arlind Azemi nga Prishtina, bazuar në aktet noteriale “Kontratë për qira” me LRP.nr.3803/2021 dhe Ref.nr.653/20201 dt.30.07.2021; LRP.nr.3954/2021 dhe Ref.nr.687/20201 dt.05.08.2021, të përpiluara te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë, me kërkesën 05nr.350/02-184195/21 dt.21.09.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa afariste me Karakter të përkohshëm dhe me destinim: Pikë e shitjes së karburanteve, restorant, barnatore & market, me P+0, në kuadër të parcelave të lartcekura, ku kjo drejtori me Vendim 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, ka caktuar kushtet ndërtimore.

Subjekti juridik, “Hill OIL”sh.p.k. nga Prishtina, pas zhvillimit të procedurave të parapara me Vendimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, si bashkimi dhe ndarja e parcelave kadastrale, hartimit të dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor dhe sigurimin e pëlqimeve përkatëse, me kërkesën 05nr.351/02-254680/21 dt.23.11.2021, ka aplikuar për leje ndërtimi.

Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës së lartcekur, ka filluar zhvillimin e procedurave për trajtimin e kërkesës për leje ndërtimi, duke proceduar shkresën “Akt përcjellës, informim dhe kërkesë” 05nr.351/02 – 87209/22 dt.11.05.2022, në DIKMK, e cila drejtori me “Marrëveshje për pagesën e tarifës rregullative të infrastrukturës” të datës 14.02.2022, përcjell përmes shkresës - aktit përcjellës

me referencë 05nr.351/02 – 254680/21 dt.30.11.2021, ka arritur marrëveshjen për infrastrukturë me kërkuesin/subjektin juridik "Hill OIL"sh.p.k. Njëherë me "Pëlqim" në dokumentacionin investivo – teknik, Elaborat i mbrojtjes nga zjarri, për objektin, me karakter të përkohshëm afarist me etazhitet P+0 në "Çagllavicë" nr.1510/2022 dt.14.04.2022, të lëshuar nga MPB –AME në Prishtinë, është siguruar pëlqimi kundër zjarrit, si dhe duke u prezantuar pëlqimet përkatës të kompanive publike. Në vazhdim, kjo drejtori me Aktvendim 05nr.351/02 – 254680/21 dt.20.07.2022, ka caktuar taksën administrative për leje ndërtimi të cilën kërkuesi me faturën e datës 01.08.2022, e ka realizuar pagesën në "IFJB FINSER"sh.p.k. në Fushë Kosovë.

Më tutje, në procedurën administrative të shqyrtimit të kësaj kërkesë, përkatësisht në fazën e pozicionimit të ndërtesës nga gjeodeti i drejtorisë, në kuadër të parcelës kadastrale nr.1952-0 ZK Çagllavicë, është shprehur dyshimi se një pjesë e kësaj parcele është trajtuar në procesin e ndërtimit të pjesës lidhëse të rrugës – magjistrales me autostradën Ibrahim Rugova. Për qartësim të kësaj që u tha, përmes postës elektronike të datës 12.09.2022, nga Departamenti i Shpronësimit i MMPH-së, është kërkuar informacion lidhur me këtë çështje, i cili departament – zyrtari përgjegjës, përmes shkresës me postë elektronike të datës 12.10.2022, ka konfirmuar pranimin e shkresës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe ka caktuar takim në zyrat e Drejtorisë së Urbanizmit me datë 13.10.2022. Gjatë mbajtjes së këtij takimi me dy zyrtare të Departamentit të Shpronësimit, znj. Leonita Ademaj, gjeodete dhe znj. Gjylsine Gërbeshi, të njëjtat kanë konstatuar se kjo pjesë është shpronësuar, duke prezantuar fotokopjet e akteve të shpronësimit (dhe kanë premtuar se do të na i përcjellin të njëjtat përmes postës elektronike, por të njëjtat si kanë prezantuar). Pas këtyre konstatimeve Drejtorja e Urbanizmit e ka informuar kërkuesin për konstatimet e Departamentit të Shpronësimeve, andaj edhe pjesa e parcelës kadastrale tani nr.1952-0 ZK Çagllavicë (pas bashkimit) duhet të largohet nga trajtimi.

Subjekti juridik "Hill OIL"sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139, dhe me pronar Hekuran Pasha nga Peja, rr."Jashar Pasha"nr.16, pas ndarjes së parcelës nr.1952-0 ZK Çagllavicë, sipas vijës së shpronësimit, me kërkesën 05nr.350/05 – 236767/22 dt.28.10.2022, ka kërkuar nga kjo drejtori ndryshim – plotësimin e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, duke prezantuar edhe parcelat kadastrale nr.1952-1 & 1952-2 ZK Çagllavicë, si dhe projekt propozimin konceptual të ndryshuar dhe harmonizuar me parcelën e re kadastrale.

Kjo drejtori, pas pranimin të kësaj kërkesë me dokumentacionin e prezantuar, ka marrë në rishqyrtim edhe një herë kushtet ndërtimore dhe të njëjtat i ka harmonizuar me sipërfaqen e parcelës kadastrale nr.1952-1 ZK Çagllavicë, tani me $S=1565m^2$. Bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin konceptual konstatohet se është ndryshuar sipërfaqja e "Pika e shitjes – strehës në formë katërkëndëshi me dimensione: 29.40m' (jugu & veri) x 18.50m' (lindja - perëndim) me sipërfaqe totale $S=373.68m^2$, si dhe me hapësira ajrore në pjesën e veriore me $S=170.80m^2$ ", dhe është bërë në sipërfaqe prej "Pika e shitjes – strehës në formë katërkëndëshi me dimensione: 29.40m' / jugu & veri / x (8.95m' & 8.40m') /lindja – perëndim/ me sipërfaqe totale $S=253.72m^2$ ", me të cilën konstatohet se përmbushet kriteri i shfrytëzimit të parcelës prej 40%, bazuar në Rregulloren për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik, 01nr.110-288305 dt. 31.12.2014.

Andaj, si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01nr.110-288305 dt. 31.12.2014, si dhe në diskrecionin për vendosje të çështjeve të planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe në bazë të nenit 21, 44, 45 & 84 të LPPA-së Nr.05/L - 031, lidhur me ligjshmërinë për ndryshim – plotësim të kushteve ndërtimore, Drejtorja e Urbanizmit, vendosi që të miratojë kërkesën 05nr.350/03 - 236767/22 dt.28.10.2022, e kërkuesit: Subjektit juridik, "Hill OIL"sh.p.k. nga Peja, me certifikatë të biznesit ARBK 811554139, dhe me pronar Hekuran Pasha nga Peja, rr."Jashar Pasha"nr.16, për **ndryshim – plotësim** të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-184195/21 dt.19.10.2021, të caktuar

nga kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë afariste me **Karakter të përkohshëm** dhe me destinim: **Pikë e shitjes së karburanteve, restorant, barnatore & market** me P+0, në kuadër të PZHU-së, konkretisht parcelave, nr. 332-6, 332-12, 333-4 & 333-5 ZK Çagllavicë (pas ndarjes, parcela kadastrale nr.1952-1 ZK Çagllavicë), në pronësi të pronarëve / qiradhënësve: Kemal Kameri, Nebi Jusufi dhe Arlind Azemi, bazuar në aktet noteriale "Kontratë për qira" me LRP.nr.3803/2021 dhe Ref.nr.653/20201 dt.30.07.2021; LRP.nr.3954/2021 dhe Ref.nr.687/20201 dt.05.08.2021, të përpiluara te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit për ***ndryshim – plotësim*** të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e ndryshim-plotësimit të Kompleksit me ndërtesa afariste me **Karakter të përkohshëm** dhe me destinim: **Pikë e shitjes së karburanteve, restorant, barnatore & market** me P+0, në kuadër të PZHU-së, konkretisht parcelës kadastrale nr.1952-1 ZK Çagllavicë.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet: Kërkuesit, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05nr.350/05 – 236767/22 dt.28.10.2022 dhe 05nr.350/02-184195/21 dt.02.09.2021.


**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 184195/21 DT. 10.11.2022**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini

U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi

DREJTORI:
Arber Sadiki.

Investitor:	"Hill Oil" Sh.P.K
Nr. i Parcelles:	1952-0 ZK Çagllavicë
Destinimi:	Objekt me karakter të përkohshëm
Etozhieft:	P+0
Sipërfaqja Ndërtimore:	E Regjistruar S=743.59 m ² E Re S=617.59 m ²
Rëmboljio:	Pkë e shijes së karburantëve, restorant, barmatore & market



RR. RILINDJA KOMBËTARE

ARKITEKTURA

Faza:	Situacioni	
Investitor:	Objekt i Altitit	Orientimi:
"Hill Oil" Sh.P.K	Me Karakter të përkohshëm P+0	
Projektues:	Prishtinë, Republika e Kosovës	
"AKO - H" nsh. Prishtinë	Etozhieft:	
	P+0	

ALKA EKO

Projektori përkohshëm
Mazlom Bejtaja ida

251021

1:250

Nr. i fletës:
01